



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Numri i regjistrimit themeltar 8464
Data e regjistrimit 28.08.2024

Data e vendimit 15.01.2025

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga gjyqtari i vetëm:

- **Dritan CAKA** -

Në Tiranë, sot më 15.01.2025, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen tregtare që i përket:

Kërkuese: **Shoqëria “eMMe & Co” sh.p.k.**, me NIPT K92229018P, me seli në adresën: Kamëz, Bulevardi Blu, Lagjja Valias, Pronë nr. 44/126, me administrator z. Giorgio Mario Bertoli, shtetas italian, lindur me 20.07.1964, në Urago d’Olio (Bs), Itali, Banues në Calcio (Bg), Via San Fermo n. 6 (Itali), me adresë për efekt njoftimi: Rruga “Abdi Toptani”, “Torre Drin”, Kati II, Tiranë.

Objekti: Kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë “eMMe & Co” sh.p.k., me NUIS K92229018P.

Baza ligjore: Nenet 13, 14, 15 të Ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”; Nenet 334 dh), 335 të K. Pr. Civile.

Gjykata, pasi analizoi në dhomë këshillimi pretendimet e palës kërkuese, si dhe aktet që i bashkëlidhen kërkesës,

VËREN

1. Referuar ekstraktit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se shoqëria “eMMe & Co” sh.p.k., me seli në adresën: Kamëz, “Bulevardi Blu”, Lagjja Valias, Prona nr. 44/126, me NUIS K92229018P, ushtron veprimtari tregtare në fushën e prodhimit dhe tregtimit të veshjeve dhe aksesorëve.

Kapitali i kësaj shoqërie tregtare është në vlerën prej 215.300 Euro, i paguar plotësisht, dhe zotërohet nga shoqëria italiane “Duemilaquattro” S.r.l.

Kjo shoqëri përfaqësohet nga një administrator i vetëm, që është z. Giorgio Mario Bertoli.

2. Nëpërmjet kërkesës objekt shqyrtimi shoqëria “eMMe & Co” sh.p.k. ka kërkuar që nga ana e gjykatës të hapen procedurat e falimentimit të saj, me likuidim, me pretendimin se ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese.

Konkretisht, në mbështetje të kërkesës së saj për hapjen e procedurave të falimentimit, pala kërkuese ka parashtruar argumentat që vijnë:

- Në datën 09.08.2024 shoqëria ka patur të regjistruar vetëm 4 (katër) punonjës dhe që nga data 12.06.2024 ka ndërprerë aktivitetin e saj prodhues, për shkak të mungesës së

porosive nga të tretët, për të cilët prodhon veshje për sektorët e kohës së lirë dhe të veshjeve në rrugë (kryesisht bluzë tuta, tuta, pantallona tutash, etj.). Këto janë kryesisht artikuj që përdoren nga brezat e rinj, të cilët megjithatë prirën të mos përfshijnë një vlerë të lartë të shtuar ose çmime veçanërisht të favorshme shitjeje. Për rrjedhojë, edhe marzhet e fitimit për to prirën të reduktohen. Shoqëria ka operuar si “façon”.

- Tërmeti që ndodhi në Shqipëri në vitin 2019, ardhja e pandemisë “Covid-19” dhe shpërthimi i luftës në Ukrainë e përkeqësuan më tej situatën e përgjithshme të shoqërisë, për shkak të: (i) rritjes së kostove të energjisë, të cilat gërryen ndjeshëm marzhet e kufizuara të fitimit, (ii) pamundësisë për të transferuar kostot më të larta që po përballonte shoqëria tek klientët (të cilët kanë fuqi shumë më të madhe negociuese sesa shoqëria kërkuese për shkak të madhësisë së tyre).
- Pandemia nga ana e saj, e bëri të pamundur që menaxherët italianë të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. të mund të shkonin në terren për të siguruar një menaxhim efikas të saj (e cila uli ndjeshëm xhiron, duke ruajtur një strukturë kostoje të lartë): kjo ka sjellë si pasojë pamundësinë e shoqërisë për të paguar kreditë e financuara nga ana e ortakut italian shoqëria “Duemilaquattro” S.r.l., kredi/financime për të cilat, pasi janë bërë përpjekjet e nevojshme për arkëtim, është konstatuar se nuk mund të rimbursohen.
- Gjithashtu duhet nënvizuar se, gjatë periudhës së pandemisë, shoqëria gjeti mbështetje të përkohshme për biznesin e saj, duke u angazhuar gjithashtu në prodhimin e maskave për përdorim mjekësor dhe, pasi pandemia kaloi, në muajin Shkurt 2023, duke besuar ende në këtë projekt, mori me qira një godinë të re dhe moderne, dhe u ofroi punonjësve shërbimin e mensës në ndërmarrje dhe atë transportit me autobus vajtje ardhje nga puna, pa pagesë. Në pranverën e vitit 2024, duke pasur parasysh shenjat më të forta të krizës, shoqëria bëri rritje të shumta pagash për pjesën më të madhe të punonjësve, gjithmonë me synimin për të ofruar vazhdimësi me shpresën e rimëkëmbjes së tregut.
- Duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2023, ky model operimi kishte pësuar një rënie të ndjeshme të xhiros për shkak të faktorëve të mëposhtëm:
 - (i) gjendjen e përgjithshme ekonomike.
 - (ii) për specifikat e klientëve të cilët, siç u përmend, duke tregtuar veshje të përdorura gjerësisht, veçanërisht nga brezat e rinj, prirën të mos përfshijnë një vlerë të lartë të shtuar ose çmime veçanërisht të favorshme shitjeje.
 - (iii) vështirësia e tregut më të rëndësishëm outlet, atij gjerman, i cili përveçse regjistroi një kolaps të përgjithshëm në shitjen e të gjitha mallrave të konsumit, evidentoi në vitin 2024 një tkurrje shumë të fortë të shitjeve në sektorin e veshjeve siç theksohet p.sh.: qarkullimi i dy klientëve që operojnë në atë treg “Rabe” dhe “CMP”, të cilët shënuan të njëjtin trend, duke shkuar të dy nga rreth 140,000 artikuj të porositur në 2023 në zero artikuj të porositur në 2024. Për t’u përgjigjur kërkesës për këto porosi shoqëria nënkontraktoi një pjesë të punës me 4-5 ndërmarrje të tjera. Për qëllime treguese, duhet theksuar se qarkullimi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 ishte 86,752,610 Lekë, e barazvlefshme me 866,832.63 Euro, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit aktual qarkullimi ishte vetëm 30,012,591 Lekë, e barazvlefshme me 299,886 Euro.
 - (iv) prirjen tashmë të njohur të grupeve të mëdha (p.sh. “Armani” dhe “Dior”) për t’ua besuar, nëpërmjet nënkontraktimeve, prodhimin e tyre edhe në Itali, ndërmarrjeve të cilat, duke shfrytëzuar fuqinë punëtore me kosto të ulët (kineze dhe afrikano-veriore) në kundërshtim me çdo ligj, ata ulën në maksimum marzhet e fitimit në dëm të operatorëve korrektë.
 - (v) specifikave të vendit në të cilin u krye aktiviteti tipik, pra Shqipërisë, ku tendenca e kursit të këmbimit euro/lek është përkeqësuar që nga viti 2019 me rreth 25% dhe kjo ka pasur një ndikim shumë të rëndë, sepse porositë e shoqërisë janë shlyer në “Euro”, por kostot në Shqipëri janë bërë në “lekë”.

(vi) Për më tepër, në Shqipëri, dinamika e pagave ka pësuar një rritje shumë të fortë me legjislacionin që ka imponuar një rritje pagash prej rreth 53,84% (Janar 2020 paga minimale ishte 26.000 lekë, kurse në Prill 2023 u bë 40,000 lekë).

- Në këtë kuadër, duke filluar nga muaji Gusht 2023, ortakut i vetëm ka financuar vazhdimisht aktivitetin e shoqërisë me qëllim mbrojtjen e fuqisë punëtore, duke shpresuar në rimëkëmbjen e tregut, për të arritur më pas në normën e kthimit dhe në gjenerimin e fitimeve. Kjo përpjekje e ortakut të vetëm italian mund të shihet në pasqyrat financiare të shoqërisë, të cilat tregojnë një borxh për financimet e ortakut në shumën prej rreth 600.000 Euro, të barazvlefshme me 60.138.405 lekë.
- Situata ishte bërë e tillë që nuk e bënte më të mundur vazhdimin e aktivitetit të biznesit të përshtatshëm dhe të qendrueshëm dhe për këtë arsye u vendos që të procedohej me shitjen e aktivitetit ekonomik të shoqërisë ose një pjese të saj, por pavarësisht përpjekjeve nuk u identifikuan persona të interesuar për blerien e saj.
- Gjithë ky informacion u raportua në mënyrë të përsëritur dhe në detaje tek menaxherët e shoqërisë dhe më pas edhe tek punonjësit.
- Pasi u mor vendimi për të pezulluar prodhimin, për shkak të mungesës së porosive, të gjithë punonjësit u informuan për nevojën për të marrë pushime vjetore me pagesë, ndërsa prisnin zhvillimet. Pas kësaj, në gjysmën e dytë të Qershorit 2024, shoqëria kontaktoi me një kompani shumë solide në këtë sektor, e cila u deklarua fillimisht e gatshme të punësonte të gjithë punëtorët për të mos lënë njeri në rrugë, por ky angazhim rezultoi pa rezultat.

Detyrimet në lidhje me pagat

- Pagat deri më 31.05.2024 janë paguar rregullisht. Përsa i përket pagave të muajit Qershor 2024, ato janë paguar në nivelin 25% për secilin punëmarrës. Përsa i përket pagave të muajit Korrik 2024, ato janë pa paguar.
- Detyrimi i shoqërisë përkundrejt punëmarrësve për pagat e papaguara është në vlerën 7,097,314 Lekë, deri më datë 09.08.2024.

Detyrimet e papaguara përkundrejt organit tatimor

- Për sa i përket detyrimeve tatimore (TVSH, Tatim në Burim, Tatim Fitimi, Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat personale etj.) shoqëria i ka paguar rregullisht, ato deri për muajin Maj 2024.
- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me detyrimet tatimore që rezultojnë ende të papaguar është në vlerën 3,535,070 Lekë, plus interesat;
- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me TVSH, që rezulton ende i papaguar është në vlerën 482,210 Lekë, plus interesat për vonesë në pagesë për muajin Korrik 2024.
- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me tatimin në burim, që rezulton ende i papaguar është në vlerën 121,761 Lekë, plus interesat për vonesë në pagesë për muajin Qershor 2024.
- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me sigurimet shoqërore e shëndetësore të papaguara është në 2,523,421 Lekë, plus interesat për vonesë në pagesë për periudhën Qershor - Korrik 2024;
- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale të papaguara është në vlerën 420,063 Lekë, plus interesat për vonesë në pagesë për muajin Qershor - Korrik 2024.

Situata në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme

- Aktualisht shoqëria nuk ka në pronësi apo përdorim pasuri të luajtshme (përfshirë edhe ato të regjistrueshme) apo të paluajtshme.

Situata në lidhje me bilancet aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave

- Situata në lidhje me bilancet aktuale të parave gjendje është në vlerën 99,507 lekë dhe gjendet si më poshte vijon:

- Gjendja në llogarinë e shoqërisë pranë Bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” në numrin e llogarise 38301335302 në monedhën “Lekë” është në vlerën 97.57 Lekë;
- Gjendja në llogarinë e shoqërisë pranë Bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” në numrin e llogarise 38301335301 në monedhën “Euro” është në vlerën 0 Euro;
- Shoqëria ka një “overdraft” në vlerën 19.998,17 Euro të papaguar më 09.08 2024;
- Gjendja në llogarinë e shoqërisë pranë Bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” në numrin e llogarise 38301335306 në monedhën GBP është në vlerën 5.00 GBP;
- Burimet e të ardhurave janë nga aktiviteti i shoqërisë dhe shitja e aseteve.
- Shoqëria nuk ka llogari të tjera bankare.

Situata në lidhje me kreditorët

- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me kreditorët për detyrimet tregtare të papaguara është në vlerën 8,359,943 Lekë.
- Detyrimi i shoqërisë në lidhje me kreditorët banka (overdraft) është në vlerën 4,003,037 Lekë, e barazvlefshme në vlerën 39,998.37 Euro.
- Lista e kreditorëve deri në datën e kësaj kërkesë, vlera dhe burimi i detyrimeve për secilin gjenden të pasqyruar në listën që bashkëlidhet kësaj kërkesë.

Situata në lidhje me ortakun e vetëm të shoqërisë (financimet afatgjata).

- Detyrimi i shoqërisë përkundrejt ortakut të vetëm, për shkak të financimeve të këtij të fundit, është në vlerën 60,338,405 Lekë.
- Vlerat dhe datat e financimeve gjenden të pasqyruar në listën që bashkëlidhet kësaj kërkesë.

Situata në lidhje me debitorët

- Detyrimet përkundrejt shoqërisë nga debitorët (klientët) e saj janë në vlerën 1,858,987 Lekë.
- Lista e debitorëve vlera dhe burimi i kredive për secilin gjenden të pasqyruara në listën që bashkëlidhet kësaj kërkesë.

Bilancet e shoqërisë me humbje të kapitaleve të veta

Duke iu referuar bilanceve të shoqërisë për vitet 2021, 2022 dhe 2023 ato rezultojnë me humbje të kapitaleve të veta për tre vite të një-pas-njëshme dhe më konkretisht:

- Në bilancin e vitit 2021 shoqëria ka rezultuar me humbje të kapitalit të vet në shumën 21,623,370 Lekë;
- Në bilancin e vitit 2022 shoqëria ka rezultuar me humbje të kapitalit të vet në shumën 20,465,352 Lekë;
- Në bilancin e vitit 2023 shoqëria ka rezultuar me humbje të kapitalit të vet në shumën 32.140,650 Lekë.

Procedurat ligjore në të cilat mund të jetë palë shoqëria

- Për sa jemi në dijeni, deri në datën e kësaj kërkesë, nuk ka asnjë procedurë ligjore ku Shoqëria është palë si paditës apo i paditur.

E ardhmja e shoqërisë

- Shoqëria ka shqyrtuar të gjitha mundësitë dhe zgjidhjet e mundshme për të siguruar vazhdimësinë e biznesit, duke iu drejtuar edhe blerësve të palëve të treta. Aktualisht, situata e tregut nuk tregon shenja përmirësimi dhe për këtë arsye perspektivat për vazhdimësi të aktivitetit të shoqërisë duken ende jashtëzakonisht kritike.
- Edhe vetë ortaku i vetëm i saj “Duemilaquattro” S.r.l. ndodhet në të njëjtën situatë, pasi për të rezulton të jetë hapur procedura e falimentimit në Itali, me vendim të Gjykatës së Bergamos, Sent. N. 153/2024, pubbl. 24.07.2024, Rep. N. 172/2024, del 24.07.2024.

- Ndodhur në këto kushte shoqëria ka qenë e detyruar të zgjidhë kontratat e punës me të gjithë punëmarrësit e saj, të zgjidhë kontratën e qirasë për ambientin ku ushtronte aktivitetin prodhues dhe të shesë asetet e saj, të cilat po zhvlerësoheshin nga dita në ditë, me qëllim për të përballuar detyrimet emergjente pagesa taksash, pagat, sigurimet shoqërore, si dhe detyrimet për qiranë, ujin dhe energjinë elektrike.
- Për pasojë, në kushtet kur nuk është në gjendje të paguajë borxhet e saj, shoqëria “eMME & Co” sh.p.k. është detyruar të paraqesë këtë kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit, me qëllim shlyerjen e detyrimeve nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të saj.

3. Kërkesës së saj për hapjen e procedurave të falimentimit shoqëria “eMME & Co” sh.p.k. i ka bashkëlidhur dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga neni 14/2 i Ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”, si vijon:

- Raportin e vet shoqërisë kërkuese, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza për të ardhmen e biznesit;
- Ekstraktin historik të lëshuar nga QKB për shoqërinë kërkuese;
- Bilancin dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit 2021 - 2023 të aktivitetit të shoqërisë kërkuese;
- Listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;
- Listën e kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;
- Listën e kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë (nëse është rasti), si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;
- Listën e debitorëve të shoqërisë kërkuese, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;
- Listën e të gjitha procedurave ligjore ku shoqëria kërkuese është palë, si paditës ose i paditur.
- Dokumentat, e mësipërme, dorëzohen në origjinal, dhe janë të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga deklaratat, në të cilën shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë.

Ky dokumentacion përfaqëson gjendjen e shoqërisë kërkuese “eMME & Co” sh.p.k. në datën 09.08.2024, e cila pretendon se nëpërmjet tij provohet që ajo është në pamundësi për të paguar detyrimet e saj të vërtetuara dhe të bëra të kërkueshme.

4. Mbi këtë bazë, shpëria “eMME & Co” sh.p.k. ka kërkuar nga gjykata që të vendosë:

- Hapjen procedurës së falimentimit për shoqërinë “eMME & Co Sh.p.k, mej NUIS K92229018P, për shlyerjen detyrimeve nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të saj dhe shpërndarjes së të ardhurave;
- Emërimin e administratorit të falimentimit.

5. Gjkata, pasi analizoi kërkesën dhe provat që i bashkëlidhen asaj (të përmendura më lart), vlerëson se ekzistojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 110/2016 “Për falimentimin” që të hapen procedurat e falimentimit për shoqërinë “eMME & Co” sh.p.k.

5.1 Kështu, duke iu referuar ligjit në fjalë rezulton se procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo të mbingarkesës me borxhe.

Konkretisht, në nenin 2 të këtij ligji parashikohet se:

“Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave.”

Pra, kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse vlerësohet se shitja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani riorganizimi (shëndetësimi) për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Sipas kritereve të ligjit, fillimi i procedurës së falimentimit realizohet vetëm nëse konstatohet ekzistenca e dy shkaqeve konkrete, që janë:

- a) gjendje e paaftësisë paguese e subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim ose dhe
- b) mbingarkesa e subjektit me borxhe.

Legjitimitimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit e gëzojnë kreditori, debitori si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale 3-vjeçare.

Konkretisht, në nenin 13 të ligjit nr. 110/2016 parashikohet se:

“Fillimi i procedurës të falimentimit mund të kërkohej nga debitori ose kreditorët në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.”

Sipas nenit 14 të të njëjtit ligj, në rastin kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vet subjekti debitor, ky i fundit duhet të vërtetojë se është në kushtet e paaftësisë paguese aktuale ose në një të ardhme të afërt, si dhe t’i bashkëlidhë kërkesës një sërë dokumentash në mbështetje të këtij pretendimi.

Konkretisht, në këtë dispozitë ligjore parashikohet se:

“1. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;

b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;

c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për atë sa kjo periudhë është;

ç) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:

i) vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;

ii) vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;

iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose

iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe

v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;

d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;

dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;

e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;

ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;

f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

2. Dokumentet, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë origjinale, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Nëse ka arsye të bazuara se përmbajtja e dokumenteve nuk është e plotë ose e saktë, duhet të përcaktohet shprehimisht në tekstin e deklaratës. (...)”

5.2 Referuar sa më lart, gjykata konstaton së pari se pala kërkuese shoqëria “eMMe & Co” sh.p.k. legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e debitorit në procedurën e falimentimit, pra ka një interes me karakter pasuror, duke qenë se bëhet fjalë për pasurinë e vet kësaj shoqërie.

Po kështu, vendimi për paraqitjen e kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit është marrë nga organi kompetent i shoqërisë, që është pikërisht ortaku i vetëm i saj.

Nga ana tjetër, bashkëlidhur kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit janë paraqitur të gjithë dokumentat dhe informacioni i parashikuar në nenin 14 të ligjit nr. 110/2016, i cituar më lart.

Ndërkohë, siç është parashtruar më lart, nga ana e palës kërkuese është bërë një analizë e plotë, e bazuar në këto dokumenta, prej nga rezulton që ky subjekt tregtar është në gjendjen e paafësisë paguese dhe të mbingarkesës me borxhe.

Në rrethanat e mësipërme, duke qenë se vërtetohet ekzistenca e kushteve për hapjen e procedurave të falimentimit të parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 110/2016, sikurse janë paafësia paguese dhe mbingarkesa me borxhe, gjykata vlerëson se duhet të vendoset pranimi i kërkesës dhe hapja më datë 15.01.2025, ora 12:30, të procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k., duke emëruar si administratore falimenti Znj. Vullnetare Çela.

5.3 Me hapjen e procedurave të falimentimit të gjithë kreditorët e shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. duhet të paraqesin pretendimet e tyre pranë administratores falimentimit, brenda 45 diteve nga shpallja e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Mbledhja për raportim e kreditorëve të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. do të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Mbledhja për verifikim e kreditorëve të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. do të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve të tyre.

5.4. Në zbatim të kriterëve të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”, për efekte të publikimit të këtij vendimi urdhërohet:

- Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin e të gjitha Drejtorive Vendore të ASHK dhe kryerjen e veprimeve përkatëse.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Shqiptar.
- Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. znj. Vullnetare Çela, e cila bazuar në kriteret e ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”, ngarkohet edhe me kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike si më lart.

Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit.

6. Së fundit, bazuar në nenin 106 të K. Pr. Civile, shpenzimet gjyqësore, që përbëhen nga taksa mbi aktet, shpenzimet për ekspert dhe shpenzimet për njoftime, i ngarkohen palës kërkuese.

Për këto arsye

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306-31) të K. Pr. Civile, si dhe në ligjin nr. 110/2016 “Për falimentimin”,

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Hapjen në orën 12:30, të datës 15.01.2025, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k., me NIPT K92229018P, me seli në adresën: Kamëz, Bulevardi Blu, Lagjia Valias, Pronë nr. 44/126, me administrator z. Giorgio Mario Bertoli, shtetas italian, lindur me 20.07.1964, në Urago d’Olio (Bs), Itali, banues në Calcio (Bg), Via San Fermo n. 6 (Itali), me adresë për efekt njoftimi: Rruga “Abdi Toptani”, “Torre Drin”, Kati II, Tiranë.
3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “eMMe & Co” sh.p.k. të znj. Vullnetare Çela, e regjistruar në listën e administratorëve të falimentit me nr. 28 license, me adresë: Rruga “Vaso Pasha”, Pallati 27, Shkalla 4, Apartamenti 4, Tiranë.
4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. të paraqesin pranë administratores së falimentimit pretendimet e tyre, brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi në QKB.
5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “EMMe & Co” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.
6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit shoqëria “eMMe & Co” sh.p.k. t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Vullnetare Çela.
7. Mbledhja për raportim e kreditorëve të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
8. Mbledhja për verifikim e kreditorëve të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.
9. Urdhërohet publikimi i shkurtimeve të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në Fletoren Zyrtare.
10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i njoftohet administratores së falimentimit znj. Vullnetare Çela.
11. Një kopje e shkurtimeve të vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin e të gjitha Drejtorive Vendore të ASHK dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me kriteret e ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Shqiptar.
16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “eMMe & Co” sh.p.k. t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.
18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.
19. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më 15.01.2025

GJYQTAR
Dritan CAKA -



Vendimi mori formë të prerë pasi
nuk u ankimua më dt. 14.02.2025
Tiranë më dt. 14.02.2025

K / SEKRETAR
MIMOZA TAFI

